

URDHËR
Nr. 27, datë 12.3.2024

PËR SHFUQIZIMIN E KOMPETENCAVE TË DELEGUARA

Në mbështetje të neneve 22, 28, 29 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, në pamundësi të prezencës për një periudhë të pacaktuar kohe të znj. Alketa Çeli, me detyrë kancelar i institucionit, dhe me qëllim garantimin e vijueshmërisë normale të punës,

URDHËROJMË:

1. Shfuqizimin e kompetencave të deleguara me urdhrin e Komisionerëve Publikë nr. 47, datë 16.5.2022, “Për delegim kompetencash”, kancelarit të institucionit, znj. Alketa Çeli.

Ky urdhër hyn në fuqi në datën 12.3.2024 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERËT PUBLIKË
Florian Ballhysa, Irena Nino